

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Mybera Latifi, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit H. K., nga fshati T., komuna e D., për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së shtetit, PP/I.nr.152/16 të dt.07.04.2016, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.17.05.2016, në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij av.Rr. H., sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht:

A K T G J Y K I M

I akuzuari H. K., i biri i N. dhe S., e gjinisë H., i lindur me dt. *data e lindjes...*, nga fshati T., komuna e D., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i pamartuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse

Me dt.13.03.2016, rreth orës 13.55, në shitoren e fshatit T., komuna e D., i akuzuari H. K., me dashje i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarit S. K., në atë mënyrë që derisa i pandehuri dhe i dëmtuari kanë qenë duke punuar në ndërmarrjen ndërtimore ‘...’ me seli në D., i dëmtuari ka punuar si mjeshtër ndërtimi, ndërsa i akuzuari si punëtor fizik, dhe gjatë kohës së punës kanë pasur mosmarrëveshje lidhur me kryerjen e punës, i dëmtuari i ka thënë se po i shmangesh punës, po fshihesh e nuk po punon, dhe mos eja më tutje në punë, ndërsa i akuzuari i ka thënë se po më cakton punë më shumë se të tjerëve dhe në muajin nëntor të vitit 2015, e ndërprej punën, pastaj në fillim të muajit mars të vitit 2016, fillon përsëri të punoj dhe rastësisht derisa ka qenë duke shkuar në punë, është takuar tek shtëpia e të dëmtuarit, i njëjti i thotë mos eja në punë se ndahemi ndryshe, dhe me datën e lartcekur i dëmtuari kishte shkuar për të luajtur biliardo në fshatin e tij, gjatë asaj kohe shkon në shitore së bashku me punëtorin e shitores A. K. dhe me V. e D. K., dhe gjatë hyrjes në shitore, i fundit ka qenë i akuzuari H. K., në atë moment ka hyrë edhe i dëmtuari dhe kanë filluar të rrahën në mes veti, dhe i pandehuri e nxjerr armën e ftoftë thikën dhe e godet dy herë, dhe pastaj ikë nga vendi i ngjarjes, me ç’rast të dëmtuarit i shkakton plagë prerëse shpuese në regjionin e majtë të gjoksit, në prani të gjakut të lirë në hapësira të lira të regjionit të majtë të gjoksit, dhe plagë prerëse shpuese në regjionin e majtë i dorë, me ndërprerje të kontinuitetit të faqes dorëzale të veshkës së majtë, e si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore, e që pasojat në shëndet kualifikohet në raportet bazuar në raportet mjekësore dhe nga vizitat kontrolluese mjekësore jo më herët se 6 muaj nga fillimi trajtimit mjekësor.

-me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 të KPRK-së

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 4, 41, 45, 74,75, dhe 189 par.5 të KPRK-së si dhe nenit 359, 365, 366, 367, 368, 450, 453 dhe 463 të KPPRK, e:

GJYKON

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet, i cili dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.13.03.2016 deri më dt.17.05.2016.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, shumën prej 100 (njëqind) €, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari S. K. nga fshati T., komuna e D. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Të akuzuarit i ndërprehet masa e paraburgimit konform nenit 367 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë –DKR ka paraqitur aktakuzë PP/I.nr.152/16 të dt.07.04.2016 kundër të akuzuarit H. K., për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, me dt.17.05.2016, dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale me të cilën është akuzuar.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të kryerjes së veprës penale, pranimi i cili është bërë vullnetarisht, pranimi i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj veprë penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit H. K., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, që me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ta vlerësojë pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. K., av.Rr. H., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke pas për bazë faktin se i akuzuari në mënyrë shumë të sigurtë e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale, i njëjti ka shpreh keqardhje dhe pendim të thellë për këtë veprë penale, se familja e të akuzuarit kanë arritur pajtim me familjen e të dëmtuarit sipas traditave zakonore, i ka propozuar gjykatës që përveç këtyre rrethanave lehtësuese pranimin e fajësisë ta vlerësojë si rrethanë veçanërisht lehtësuese dhe të njëjtit t'ia shqiptoj një sanksion penal i cili mjaftueshëm do të ndikojë në riedukimin dhe risocializimin e të akuzuarit.

I akuzuari H. K. në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështetë në tërësi fjalën e mbrojtësit duke shtuar që rrethanat të cilat i ka propozuar mbrojtësi gjykata ti vlerësojë dhe ti aprovojë si rrethana lehtësuese, përkatësisht veçanërisht lehtësuese dhe të njëjtit t'ia shqiptoj një sanksion penal sa më të butë të mundshëm ligjor.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se, i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sqartë, sjellja dhe qëndrimi i tij shumë korrekt në gjykatë, pendimi i thellë i tij për këtë veprë penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris asnjëherë këto veprime, asnjëherë nuk ka ardh në konflikt me ligjin, e në mungesë të rrethanave rënduese të akuzuarit ia shqiptoj sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 41 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil, është marrë pasi që pala e dëmtuar nuk ka qenë i pranishëm në seancën e shqyrtimit fillestar, ku i akuzuari e ka pranuar fajësinë, dhe të njëjtit nuk kanë pasur mundësi të deklarohen lidhur me këtë kërkesë, derisa deri më tani me asnjë parashtrësë paraprakisht nuk e kanë precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që, të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë lidhur me këtë çështje, konform nenit 463 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e revoles dhe mjeteve tjera me të cilat është kryer kjo veprë penale, është marrë konform nenit 69 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKRnr.195/16 të dt.17.05.2016

Procesmbajtësja
Mybera Latifi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.